



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.01.2019, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

1. Miratim i kalendarit 3 -javor të punës së komisionit.
2. Miratim i procesverbaleve të datave 11.12.2018, 12.12.2018, 17.12.2018, si dhe 18.12.2018.
3. Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Paulin Sterkaj, Xhemal Qefalia, Vullnet Sinaj, Luan Duzha, Luan Harusha, Aqif Rakipi, Anduel Xhindi, Antoneta Dhima, Spartak Braho, Klodiana Spahiu, Andon Frrokaj, Luan Rama, Myslim Murrizi, Isuf Çelaj, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Braimllari dhe Xhemal Gjunkshi.

Mungojnë:

Elona Hoxha dhe Pjerin Ndreu

Të ftuar:

Rovena Voda - Zëvendësministre e Brendshme

Tomorr Duro - përfaqësues i Departamenti të Kufirit dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme

Silvana Dervishi - Specialiste në Sektorin e Marrëveshjeve në Ministrinë e Brendshme

Renata Balliu - Shefe Sektori e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Brendshme

Ingri Vorfi - Specialsit në Drejtorinë e Integritetit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve
në Ministrinë e Mbrojtjes

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Përfitoj nga rasti t'ju uroj të gjithë kolegëve, qoftë të maxhorancës, qoftë të opozitës: suksese në këtë sesion të ri parlamentar!

Sipas rendit të ditës që u është bërë me dije të gjithë anëtarëve të komisionit sot në këtë mbledhje kemi parashikuar miratimin e kalendarit 3-javor të komisionit, miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve që ne kemi zhvilluar në fund të muajit dhjetor, si edhe shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Kolegë, jemi dakord me pikën e parë të rendit të ditës? Po.

Faleminderit!

Po kështu besoj se nuk keni vërejtje për procesverbalet e mbledhjeve të muajit dhjetor.

Miratohen.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Për të prezantuar këtë projektligj kemi të ftuar zonjën Rovenë Voda, zëvendësministre e Brendshme, zotin Tomorr Duro nga Departamenti i Kufirit dhe Migracionit.

Faleminderit!

Zonjën Silvana Dervishi, specialiste në Sektorin e Marrëveshjeve në Ministrinë e Brendshme, zonjën Renata Balliu, shefe e Sektorit të Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Brendshme, si edhe kapitenin Ingri Vorfi, specialist në Drejtorinë e Integritetit Koordinimit dhe Marrëveshjeve në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ju faleminderit për prezencën!

Dua t'ju uroj dy kolegeve të reja anëtare të këtij komisioni zonjave Antoneta Dhima dhe Elena Xhina, suksese!

Mirë se keni ardhur në Komisionin për Sigurinë Kombëtare!

Fjala është për ju, zonja Voda për të na prezantuar projekt marrëveshjen.

Rovena Voda – Sot jemi në këtë komision për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”.

Ky projektakt ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është forcimi i bashkëpunimit në fushën operacionale, së pari për të luftuar emigracionin e paligjshëm, krimin ndërkufitar, si edhe kryerjen e operacioneve të kthimit dhe të ripranimit në lidhje me menaxhimin e kufijve. Do të doja të bëja edhe një prezantim të Frontex-it, pra çfarë është Agjencia Europiane e Kufirit dhe Rojës Bregdetare. Frontex-i është një agjenci, e cila promovon, koordinon dhe zhvillon menaxhimin e integruar të kufirit në linjë me të drejtat themelore të BE-së, me konceptin e menaxhimit të integruar të kufirit.

Frontex-i është krijuar për të vepruar si një agjenci brenda vendeve të BE-së, por me rregulloren e re të Frontex-it, duke u zgjeruar edhe veprimtaria e kësaj agjencie, është parë si një element kyç i saj edhe bashkëpunimi operacional edhe me vende të treta, vende që nuk janë pjesë e BE-së, nuk janë anëtare të BE-së. Më vjen mirë të them sot këtu se Shqipëria, duke qenë se një nga detyrat e shtëpisë, në kuadër të hapjes së negociatave dhe të detyrave të lëna nga BE-ja në kuadër të kapitullit 24, ka qenë nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje me Frontex-in, është vendi i parë nga vendet e Ballkanit Perëndimor që e ka finalizuar këtë marrëveshje, e cila do të jetë një vlerë e shtuar në rritje të sigurisë kufitare të Shqipërisë me vendet e BE-së, me të cilat ajo ndan kufij, në rastin konkret kemi Greqinë dhe Italinë.

Dua të bëj edhe një prezantim të shkurtër për lidhjen e Shqipërisë me Frontex-in. Pavarësisht finalizimit të kësaj marrëveshjeje, ajo është pak e vjetër, lidhja *de facto* operacionale, daton që nga viti 2009, marrëveshjet e para, bashkëpunimet me Frontex-in i kemi pasur që nga vitit 2009, por oficerët e Frontex-it kanë pasur statusin e vëzhguesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ekspertët kanë gjithmonë dëshirë të flasin kur është fusha e tyre.

Me këtë marrëveshje oficerët e Frontex-it do të kenë të drejta të marrin rol ekzekutiv, do të bashkëpunojnë me oficerët tanë të Kufirit dhe të Migracionit, si dhe do të kenë mundësi të ekzekutojnë bashkë plane operacionale të përbashkëta.

Tri janë shtyllat kryesore apo linjat kryesore të kësaj marrëveshjeje: fokusi, parandalimi i migracionit të paligjshëm, krimi ndërkufitar dhe kryerja e operacioneve të përbashkëta në pjesën e kufirit në drejtim të menaxhimit të integruar të tij.

Unë e shikoj si vlerë të shtuar jo vetëm në rritje të sigurisë kufitare nisur edhe nga flukset migratore: Turqia, Greqia pse jo dhe Shqipëria, siç e dimë kohët e fundit është prekur nga ato, por edhe në drejtim të kapaciteteve njerëzore, do të kemi oficerë që do të punojnë bashkë me oficerët tanë. Ky lloj bashkëpunimi do të shërbejë si një lloj trajnimi për ta, por edhe vlerë e shtuar në drejtim të kapaciteteve logjistike për shkak të pajisjeve, mjeteve që ata do të përdorin, por që do t'i shërbejnë edhe sigurisë sonë kufitare. Në vija të përgjithshme kjo është marrëveshja.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Voda!

Fjalën e ka zoti Qefalia, që është relator për këtë projektligj.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Ju e filluat fjalën tuaj, duke ju uruar mirëseardhjen dy kolegeve tona. Unë sinjerisht përtej konceptimit politik, doja ta vlerësoja kthimin e opozitës në Komisionin e Sigurisë, pasi kjo i jep një formatizim më të saktë problematikës që ka vetë ky komision.

Si relator në këtë projektligj që sapo prezantoi zëvendësministrja, unë nuk do të ndalem gjatë, por do të përmend se cilat janë objektivat dhe ku synon kjo marrëveshje.

Së pari, kjo marrëveshje synon rritjen e nivelit të bashkëpunimit të vendit tonë me vendet e BE-së në kuadrin e menaxhimit të kufijve dhe emigracionit të paligjshëm, si dhe gjatë zhvillimit të operacioneve të kthimit dhe ripranimit.

Së dyti, do të jetë me shumë interes nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje pasi ka të bëjë edhe me pjesëmarrjen në operacione të përbashkëta dhe trajnime që bëhen midis dy palëve, duke vazhduar me rritjen e nivelit profesional të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e detyrave, kompetencave për menaxhimin dhe zgjidhjen e situatave dhe së fundi në rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin e informacionit, krijimin e mundësisë për përdorimin e aseteve teknike dhe logjistike edhe në kufijtë e vendit tonë, në rastet e mundshme të flukseve të mëdha migratore, të papërballueshme në momentet e para në varësi të kapacitetet njerëzore dhe teknike të vendit tonë.

Kjo është një marrëveshje që rrit më tej masat e sigurisë sidomos në aspektin e Rojës Bregdetare. Prandaj do t'i ftoj kolegët që ta miratojmë këtë marrëveshje, pasi rrit edhe sigurinë publike në vendin tonë.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia për prezantimin e marrëveshjes!

Është e qartë që kjo marrëveshje i lejon shtetit shqiptar, përkatësisht Rojës Bregdetare dhe Policisë Kufitare të bashkëveprojnë me Agjencinë Europiane për Rojën Bregdetare dhe Kufirin në mbrojtjen e kufirit dhe njëkohësisht në përballimin e të gjitha fenomeneve që lidhen me migracionin e paligjshëm, me operacione që në vetvete kanë të bëjnë me migracionin e paligjshëm, siç janë ato të rikthimit apo të pranimi të migrantëve.

Është një marrëveshje që i vlen Shqipërisë për faktin, sepse tregon se Shqipëria është një partner i besueshëm.

Agjencia Europiane për Rojën Bregdetare dhe Kufirin është një agjenci e re, që është krijuar në vitin 2016, pavarësisht se më përpara ka pasur veprime të tilla dhe marrëdhënie ndërmjet shtetit shqiptar, por fakti që ne hyjmë në këto marrëveshje është pozitiv për vendin tonë.

Unë dua të ftoj kolegët nëse kanë pyetje, pare se të kalojmë në miratimin në parim të kësaj marrëveshjeje. Kush ka pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme? Ne kemi ftuar edhe një përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes për faktin se Roja Bregdetare është një organizëm, i cili varet nga Ministria e Mbrojtjes dhe në këto marrëveshje, edhe Roja Bregdetare, edhe Policia Kufitare marrin detyrimet përkatëse.

Po, zoti Rama.

Luan Rama – Faleminderit, zonja kryetare!

Kam 2-3 pyetje për autoritetet që mbrojnë projektin në komision.

Pyetja e parë është për zonjën zëvendësministre: a kemi raste të tjera, që forcave policore të huaja ose forcave të huaja të armatosura t'u jetë dhënë e drejta e përdorimit të armëve në territorin e Republikës së Shqipërisë?

Pyetja e dytë: meqenëse kjo marrëveshje synon të administrojë, të kontrollojë dhe të strukturojë më mirë çështjen e fluksit të emigrantëve që eventualisht vijnë në kufijtë e Republikës së Shqipërisë, çfarë parashikon konkretisht, në raport me emigrantët potencialë, pranimin e tyre, refuzimin siç bëhet brenda logjikës së veprimit të shumë vendeve anëtare të BE-së, për shembull siç vepron Italia, e të tjerë? Nëse parashikon pranimin, çfarë kapacitetesh ka vendi ynë për të administruar një fluks të mundshëm të migrantëve që vijnë nga zona të ndryshme, kryesisht nga zonat e luftërave?

Pyetja e tretë: cili është autoriteti partner i kësaj force në Republikën e Shqipërisë: është Policia Kufitare apo Roja Bregdetare? Sepse autoritetin e zbatimit të ligjit në kufijtë detarë të Republikës së Shqipërisë e ka Roja Bregdetare.

Ermonela Felaj - Po, zonja Voda, fjala është për ju.

Rovena Voda - Unë do të përgjigjem dhe nëse ka nevojë për të shtuar diçka, janë edhe ekspertët.

Për pyetjen e parë, dua të them se nëse kthehemi mbrapa në kohë, me sa mbaj mend kanë qenë operacionet “ALBA” në 1997-tën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë më mirë nëse ka pasur ndonjë rast tjetër.

Ermonela Felaj- Të dëgjojmë përgjigjet njëherë.

Rovena Voda- Kaq ishte pyetja dhe besoj se përgjigja mjafton.

Ermonela Felaj - Po, zoti Duro.

Tomorr Duro - Faleminderit!

Në këtë kuadër përveç asaj që sqaroi zonja zëvendësministre, dua të shtoj se ne kemi një marrëveshje me Ministrinë e Brendshme të Italisë të ratifikuar në parlamentin shqiptar në vitin 1998. Në kuadrin e Interforca-s që do të thotë pjesëmarrje të disa forcave policore italiane siç janë: policia, karabinieria dhe Guardia di Finanza është reduktuar në një zyrë ndërlidhëse, por misioni i kësaj të fundit ende vazhdon mbi bazën e katër marrëveshjeve të mëvonshme që janë bërë midis shtetit shqiptar dhe atij italian me qëllim parandalimin dhe goditjen e fenomeneve të kundërligjshme në hapësirën detare.

Aktualisht operon nukli i Kufirit Detar i Guardia di Finanza me qendër në Durrës me një efektiv rreth 36 vetë, me rreth 5 mjete lundruese të ndara, 2 në Durrës dhe 3 në Vlorë.

Luan Rama - Për sqarim, Guardia di Finanza ka autoritet të përdorë armë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë?

Tomorr Duro - Guardia di Finanza është forcë ushtarake e armatosur, e cila në të gjitha rastet e shkëmbimit të ekipeve, ato ndërrohen çdo 6 muaj, janë të detyruara të deklarojnë armatimin, vijnë me armatimin e tyre për të operuar në Republikën e Shqipërisë.

Luan Rama- Më fal! Edhe një herë, se nuk e kuptuat pyetjen.

Pyetja është: Guardia di Finanza, a ka autoritet të përdorë armët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç parashikon kjo marrëveshje?

Tomorr Duro – Jo, kjo marrëveshje parashikon përdorimin e armëve në rastet e mbrojtjes së jashtëzakonshme dhe në të gjitha rastet Rojet Kufitare në kuadrin e Frontex-it do të jenë të shoqëruara ne Rojet Kufitare të Republikës së Shqipërisë. Në rastet kur është e domosdoshme për mbrojtjen e jetës së tyre, atëherë do të përdoret edhe arma. Më pas, sipas

juridiksionit civil dhe penal të Republikës së Shqipërisë dhe të vendit përkatës, mbi bazën e analizës së drejtorit dhe të vendimit të drejtorit Ekzekutiv të Frontex-it, do të operohet...

Luan Rama - Zonja kryetare, nuk po arrij ta kuptoj pse specialisti nuk e kupton pyetjen time.

E para, kjo marrëveshje, projekti që po diskutojmë parashikon të drejtën e përdorimit të armës nga forcat e Frontex-it në të gjithë hapësirën territoriale të kufirit dhe të territorit të Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë meqenëse e di shumë mirë, sepse e kam nënshkruar unë marrëveshjen me Interforcën, Guardia di Finanza nuk është forcë ushtarake, është forcë policore dhe ka një diferencë në koncept, sepse është në varësi të Ministrisë së Brendshme italiane.

E dyta, Guardia di Finanza nuk ka autoritet të përdorë armën brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, prandaj ju pyeta. Zonja zëvendësministre tha se që nga 1997-1998 nuk kemi ndonjë rast tjetër që të autorizohet një forcë e huaj të përdorë armën brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ermonela Felaj – Po, zonja Voda.

Rovena Voda- Dua të them vetëm një gjë.

Ermonela Felaj- Kjo do të jetë përgjigjja për këtë pyetje.

Rovena Voda – Po, do të jetë përgjigjja përfundimtare. Kjo marrëveshje ruan të njëjtën linjë të rregullores së Frontex-it, pra të njëjtin rregull që funksionon midis vendeve të BE-së.

Ermonela Felaj – Janë edhe 2 pyetje të tjera.

Rovena Voda – Me sa mbaj mend pyetja ishte, nëse kjo nuk kupton praninë, dua ta sqaroj, ndoshta edhe për shkak të zhurmës që është bërë në medie, nëse Shqipëria kthehet në vend pritës, absolutisht që është dezinformim dhe këtë dua të sqaroj njëherë e mirë: në Shqipëri kur kemi flukse apo kalojnë migrantë të paligjshëm në respektim të ligjeve “Për të huajt, “Për të drejtën e azilit”, thjesht ata kur mbërrijnë u merret një deklaratë, plotësojnë një formular, nëse shihet se ata nuk përmbushin kriteret e Konventës së Gjenevës për të fituar statusin e refugjatit apo nuk kërkojnë të drejtën e azilit, ata kthehen në mënyrë vullnetare një pjesë, për pjesën tjetër, në bazë të marrëveshjeve apo protokolleve të ripranimit që ne kemi me vendet fqinje, kthehen mbrapsht, ndërsa pjesa që kërkon azil, patjetër që duhet respektuar, pra, e gjithë procedura, kur një pjesë e tyre bën kërkesë për të fituar të drejtën e azilit në Republikën e Shqipërisë.

Kjo marrëveshje nuk duhet interpretuar si një marrëveshje që Shqipëria kthehet në vend pritës për emigrantët. Më vjen shumë keq, në fakt, që e kam dëgjuar këtë gjë.

Besoj se edhe pyetja tjetër e ka përgjigjen brenda, kur thuhet nëse ka kapacitete apo jo.

Autoriteti që zbaton marrëveshjen është Departamenti i Policisë Kufitare dhe Migracionit, pasi në bazë të ligjit “Për kontrollin kufitar në Republikën e Shqipërisë”, një ligj i përafëruar me *acqui* të BE-së është pikërisht Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila mbikëqyr të tërë kufirin tokësor dhe detar të RSH-së.

Ku është roli i Ministrisë së Mbrojtjes? Roli i saj qëndron pikërisht tek ajo që përmendët ju, që ne kemi një qendër ndëroperacionale detare, pra kemi një nukël, i cili siguron bashkëpunimin e të gjitha institucioneve dhe aktorëve për sa i përket monitorimit të kufirit detar dhe këtu, sigurisht, është edhe kontributi i Ministrisë së Mbrojtjes, e cila ka edhe mjetet, pra ka anijet e Rojës Bregdetare.

Është sqaruar besoj edhe në relacion që, pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje dhe pasi të hyjë në fuqi kur të nënshkruhen planet operacionale të punës, planet do të jenë të përbashkëta dhe do të miratohen vetëm nëse Policia Kufitare dhe Migracionit bie dakord me një x plan operacional. Pra, në njëfarë mënyre ne kemi një rol vendimmarrës për operacione të caktuara, që do të kryhen në bashkëpunim me Frontex-in dhe planet miratohen nga Frontex-i, Agjencia e Kufirit dhe e Rojës Bregdetare, me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Voda!

Urdhëroni!

Luan Rama – Jam dakord me përgjigjen që dha zëvendësministrja, sepse është e vërtetë që kufirin territorial të RSH-së, qoftë atë tokësor, qoftë atë detar apo liqenor e administron DPK-ja, por kufiri detar nuk është pika e kontaktit të tokës me detin, domethënë nuk është pika e kalimit kufitar në Portin e Durrësit, fjala vjen, ndërkohë që prej aty deri në momentin kur hyhet në hapësirën e ujërave territoriale të RSH-së, autoriteti është Roja Bregdetare.

Si do të normohet, se nuk e shoh në marrëveshje raportin e bashkëpunimit midis Frontex-it dhe Rojës Bregdetare në hapësirën kur Roja Bregdetare ka autoritetin e zbatimit të ligjit? Qendra ndëroperacionale apo nukli, që përmendët ju, është tjetër gjë dhe autoriteti

ligjore që ka Roja Bregdetare në kontrollin, administrimin dhe zbatimin e ligjshmërisë në hapësirën detare është tjetër gjë.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Duro!

Tomorr Duro – Në bazë të ligjit nr.71/2016 Policia Kufitare dhe e Migracionit është agjencia përgjegjëse për kontrollin e kufirit shqiptar, që do të thotë atij tokësor, ajror dhe detar.

Roja Bregdetare ka të drejta dhe detyra për mbrojtjen dhe zbatimin e ligjshmërisë në hapësirën detare. Kjo nuk e përjashton në asnjë rast dhe në asnjë pikë Policinë Kufitare dhe Migracionit të kryejë detyrat e saj me forcat dhe mjetet e saj, në bashkëpunim me Rojën Bregdetare për kontrollin e kufirit detar. Në këtë kuadër, edhe QNOD-ja, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, në bazë të vendimit të KM-së dhe të procedurave standarde, i ka të përcaktuara qartësisht detyrimet dhe rolin e secilit institucion.

Luan Rama – Nuk më kuptuat, i dashur. Nuk po flas për bashkëpunimin midis Rojës Bregdetare dhe Policisë Kufitare. Në rastin konkret po flas për bashkëpunimi midis Rojës Bregdetare dhe Frontex-it, sepse Frontex-i është agjenci policore e BE-së, që merret me administrimin e kufijve dhe në praktikën e vendeve të BE-së kjo agjenci, të paktën me sa di unë, nuk ka partneritet me Forcat e Armatosura të vendeve respektive. Këtu pra do të kemi të bëjmë me një bashkëpunim midis një agjencie policore të BE-së dhe Forcave të Armatosura, siç është RB-ja në hapësirën ku ajo ka të drejtë apo autoritet të zbatojë ligjin për mbrojtjen e kufijve shtetëror të RSH-së. Pra, si do të normohet bashkëpunimi midis Frontex-it? A është i vlefshëm ai korpus ligjor që normon bashkëpunimin midis Policisë Kufitare apo Policisë së Shtetit me RB-në dhe Forcat tona të Armatosura, apo do të ketë një marrëveshje tjetër?

Dua të kujtoj për kolegët, që edhe Ministria e Brendshme kur, për shkak të operacioneve të përbashkëta ka nevojë apo kërkon mbështetjen e FA-së, të RB-së, të Forcave Detare apo të reparteve të tjera speciale, kjo normohet pasi nënshkruhet më parë, pasi KM-ja merr një marrëveshje bashkëpunimi midis dy ministrive, të Brendshme dhe të Mbrojtjes. Pa këtë marrëveshje nuk t'i jep forcat Ministria e Mbrojtjes për të qenë pjesë operacionale apo ndërvepruese në funksion të një operacioni të caktuar. Pra, si do të normohet bashkëpunimi midis një strukture policore siç është Frontex-i me një strukturë të FA-ve, siç është RB-ja?

Tomorr Duro - Faleminderit!

Desha të sqaroj edhe një herë se kjo marrëveshje nuk ka të bëjë fare me Rojën Bregdetare Shqiptare. Në vitin 2016 Parlamenti i KE-së miratoi rregulloren e Frontex-it, ku,

përveç forcave tokësore dhe ajrore, që po operonin për kontrollin e kufijve të jashtëm të BE-së, u përfshi edhe Roja Bregdetare e shteteve anëtare. Të gjitha vendet anëtare, përgjithësisht, Rojën Bregdetare e kanë agjenci civile, nuk e kanë agjenci ushtarake.

Roja jonë Bregdetare i ka të dy statuset, për vetë mundësitë e vendit tonë, por në këtë marrëveshje nuk përfshihet fare RBSH-ja, përfshihen Frontex-i dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin. Bashkëpunimi me RBSH-në do të vazhdojë ashtu sikurse është edhe tani në bazë të marrëveshjeve, por më lart se marrëveshjet është VKM-ja në të cilin përfshihen edhe pikat e përbashkëta kur dhe ku duhet të kërkohet mbështetje dhe ku operohet ndërmjet dy agjencive të shtetit shqiptar.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Duro!

(Deputeti Luan Rama ndërhyr.)

Ju lutem, zoti Rama, që mos ta merrni vetëm ju peng me pyetje, në kuptimin pozitiv të fjalës. Janë edhe anëtarë të tjerë që duan të bëjnë pyetje.

Luan Rama – Nëse unë bëj pyetje për ta sqaruar dhe për të mos lënë asnjë keqkuptim, besoj se kjo i shërben komisionit...

Ermonela Felaj – Bashkëveprimi i RBSH-së me Policinë e Shtetit është i rregulluar me ligjin e vitit 2002, kur është krijuar RBSH-ja.

Luan Rama – Po, zonja kryetare, e di mirë se kam qenë unë ministër i Mbrojtjes në atë kohë, por kjo marrëveshje nuk rregullon bashkëpunimin e RBSH-së me Frontex-in.

Pyetja që kam për specialistin e RBSH-së është: Ju jeni ushtarak apo civil?

Tomorr Duro – Ushtarak.

Luan Rama - Faleminderit!

Shpjegoja edhe specialistit të Ministrisë së Brendshme që statusi juaj është status ushtarak dhe jo status civil.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Vorfi, specialist në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve në Ministrinë e Mbrojtjes!

Ju i dëgjua pyetjet e zotit Rama, i dëgjua edhe përgjigjet e kolegëve të Ministrisë së Brendshme, cila është përgjigja juaj?

Ingri Vorfi – Me ligjin e vitit 2002 përcaktohet që struktura e RBSH-së është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Në zbatim të këtij ligji kanë dalë akte të tjera nënligjore dhe në këtë rast me VKM-në nr. 606, datë 4.12.2002 rregullohet rast pas rasti bashkëpunimi i

RBSH-së me shërbimet kufitare. Në këtë rast, për sa i përket, fjala vjen, operacionit kundër emigracionit klandestin, përcaktohet që proceset e diktimit, monitorimit dhe kategorizimit të objektit detar organizohen dhe ndiqen nga shërbimi i kufirit të Ministrisë së Rendit Publik në bashkëpunim me RBSH-në. Pra, rast pas rasti do të përcaktohet edhe autoriteti partner me Frontex-in, në varësi të operacionit që do të kryejmë, nëse janë operacione kundër lëndëve narkotike apo operacione kundër emigracionit klandestin.

Gjithashtu, e njëjta VKM që ka miratuar manualin e RBSH-së parashikon në pikën 3, kreu i parë, bashkëveprimin e RBSH-së. Po citoj: “Rojë Bregdetare bashkëvepron me strukturat e institucioneve shtetërore dhe subjektet privatë që kanë interesa në det bazuar në marrëveshje të përbashkëta”.

Pra, rast pas rasti do të bëhen marrëveshje ndër-institucionale të brendshme, të parashikuara në legjislacionin vendas për mirëfunksionimin e RBSH-së dhe të shërbimeve kufitare dhe në varësi të operacioneve që do të kryejnë, gjithmonë. Gjithashtu do të përcaktohet edhe partneri, i cili e kryen këtë operacion, por në këtë rast për operacionet për emigracionin klandestin më së shumti janë shërbimet për kufirin dhe migracionin të Policisë së Shtetit, pra Ministrisë së Brendshme.

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zoti Rama!

Luan Rama – Faleminderit, zonja kryetare për mundësinë që më dhatë të bëj pyetje! Ju kërkoj ndjesë nëse ju mora kohë, por gjykoj që është më mirë kështu se sa mbledhjet e komisionit të jenë formale dhe thjesht për të ngritur dorën dhe për të duartrokitur.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fakti që ne kemi ftuar përfaqësues nga dy ministrinë lidhet me kujdesin tonë që asnjë marrëveshje të mos kalojë pa u diskutuar në mënyrën më të plotë të mundshme. Po të ishin formale, unë besoj se do të kishim ftuar vetëm Ministrinë e Brendshme, se ajo është ministria propozuese, është edhe ministria që merr direkt përgjegjësitë nga marrëveshja me agjencinë europiane të kufirit dhe me RBSH-së. Pikërisht për të hedhur dritë mbi këtë pikë dhe për të trajtuar edhe një shqetësim, që në fakt ne gjatë vizitave tona te QNOD-ja, te Komanda e Forcës Detare, kemi pasur, në raport me ligjin “Për Rojën Bregdetare” kërkuam që ta shfrytëzonim këtë moment.

Kjo ishte e gjitha.

Urdhëroni, zoti Gjunkshi!

Xhemal Gjunkshi - Faleminderit!

Unë kam tri pyetje apo probleme që dua të trajtoj:

1. A ka një marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Rendit, duke pasur parasysh që RBSH-ja është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes?

2. Oficerët e Rojës Bregdetare ende nuk gëzojnë statusin e Policisë Gjyqësore. Sipas ligjit nr. 8875, datë 4.4.2002, pika 226, nuk është plotësuar kuadri ligjor për trajnime të mëtejshme me prokurorinë.

3. Në përmbledhjen shpjeguese të përmbajtjes së projekt marrëveshjes thuhet se Rregullorja e Parlamentit Europian dhe Kështillit të datës 14.9.2016 “Mbi kufirin europian dhe Rojen Bregdetare Europiane” kanë zgjeruar detyrat e agjencisë europiane për menaxhimin e bashkëpunimit operacional në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së.

Për të pasqyruar këto ndryshime ajo është emëruar Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian.

Në këtë rast kemi të bëjmë me një ndryshim të strukturës organike të FA-së dhe kjo strukturë kalon nëpërmjet Presidentit, miratohet prej tij. Ose duhet të lini termin “Rojë Bregdetare” ose duhet ta hiqni termin “agjenci” në rast se doni ta kaloni, por për të qenë sa më afër dhe të integruar në BE kërkohet termi “agjenci”.

Atëherë, në rast se kërkoni ta miratojmë termin “agjenci”, detyrimisht duhet të kalojë si një ndryshim i strukturës së FA-së, por të Forcës Detare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Urdhëroni, zonja Voda!

Ravena Voda – A ka një marrëveshje bashkëpunimi? Sigurisht që ka dhe e përmendëm këtu, duke iu referuar edhe pyetjeve që bëri zoti Rama, që ka një VKM që rregullon bashkëpunimin ndër-institucional të Policisë Kufitare dhe Migracionit, të Rojës Bregdetare, por edhe të institucioneve të tjera. Pra, është një gjë që as nuk vihet në dyshim.

Për sa i përket pjesës së statusit “oficer i Policisë Gjyqësore”, këtë status e kanë Policia Kufitare dhe Migracionit, që do të jetë kundërpala e oficerëve të Frontex-it.

Tomorr Duro – Me sa e kuptova deputetin, pyetja ishte se pse nuk zbatohet statusi i oficerit të Policisë Gjyqësore të Rojës Bregdetare.

Në ligjin “Për Rojën Bregdetare” të vitit 2002 ky status gëzohet nga oficerët e RBSH-së, ndërsa për problemet e trajnimit të tyre nga prokuroria e shtetit shqiptar mund të përgjigjet më mirë zotëria i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ermonela Felaj – Nuk është se eksiton një status mirëfilli në kuptimin e statusit për Policinë gjyqësore. Ajo që ka dashur të thotë ligji në vitin 2002 është që këta gëzojnë attribute të Policisë Gjyqësore, që do të thotë që në rast të ndeshjesh me një vepër penale në

det, këta kryejnë veprimet e para njësoj si një oficer i Policisë Gjyqësore. Pra, këto janë atributet, nuk është se ka një status Policia Gjyqësore.

Po ta shikoni edhe kalendarin, edhe programin, Policia Gjyqësore është një strukturë që ne do ta rishikojmë tërësisht, sepse me draftin e ri të Policinë Gjyqësore parashikohet që drafti ekzistues ose ligji ekzistues për Policinë Gjyqësore të shfuqizohet dhe ne të riorganizojmë tërësisht Policinë Gjyqësore edhe për shkak të ndryshimeve që ne kemi bërë në të gjithë strukturën e sistemit të drejtësisë me reformën në drejtësi.

Kështu që besoj se pyetja juaj patjetër që është me vend, por ne do të kemi rast ta rimarrim për ta trajtuar në atë ligj ku ne, në fakt, kemi përgjegjësitë tona si komision.

Ju kishit edhe një pyetje për agjencinë. Agjencia, në fakt, është mekanizëm europian...

(Diskutime pa mikrofon)

Rovena Voda – Nuk e di. Ndoshta unë nuk e kuptoj pyetjen, sepse ne thamë që kundërpala e Agjencisë Europiane të Kufirit dhe Rojës Bregdetare do të jetë Ministria e Brendshme, në rastin konkret ajo nënshkruan marrëveshjen, Departamenti i Policisë së Migracionit, marrëdhënia me Rojën Bregdetare është e rregulluar nga VKM-ja dhe marrëveshjet përkatëse që ju keni, marrëdhënie që fillon sot, prandaj nuk e kuptoj pse lind nevoja që ne të ndryshojmë emra agjencish. Më falni, po unë...

Xhemal Gjunkshi – E keni përfshirë në ligj, thuhet që në faqen e parë, neni 1.

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Gjunkshi, e ka...

Xhemal Gjunkshi – Në nenin 1, thuhet: “Ratifikimi i marrëveshjes statutore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian mbi veprimet e ndërmarrë nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë”. Pra, termi “Agjencia e Rojës Bregdetare” është ndryshuar dhe është bërë “Rojë Bregdetare”.

Rovena Voda – E keni keqkuptuar, sepse interpretimi aty është bërë gabim. I referohet Agjencisë për rolin që do të ketë në kufirin e territorit të Republikës së Shqipërisë. Jo agjencia jonë, por është Agjencia Europiane...

Ermonela Felaj – Është Agjencia Europiane e krijuar për këtë qëllim dhe bashkëveprimi që do të ketë me strukturën tonë.

Unë mendova se kishte diçka të përkthimi, sepse po ta lexosh titullin e Agjencisë në italisht dhe në anglisht përkthimi ndryshon pak. Pra, po ta lexosh në italisht ose në gjuhët latine është: Agjencia Europiane e Rojës Bregdetare dhe e Kufirit, ndërsa po të lexohej

anglisht do të përkthehej fjalë për fjalë ashtu siç vjen këtu: Agjencia e Rojës Bregdetare dhe e Kufirit European në Republikën e Shqipërisë.

Ju ftoj që ta shihni dhe ta verifikoni, por kjo gjë është mëse e qartë. Kjo Agjenci është krijuar nga Bashkimi European për qëllime të mbrojtjes së kufirit të përbashkët të të gjitha vendeve që bëjnë pjesë në zonën Shengen ose në vendet e Bashkimit European. Ne jemi në hapësirën Shengen, normalisht nuk kemi imunitet ndaj fenomeneve të reja siç janë emigracioni i paligjshëm dhe të tjera dhe për këtë arsye Shqipëria bëhet pjesë e këtij bashkëpunimi, bashkëvepron me këtë Agjenci Europiane për sigurimin e kufijve që janë brenda hapësirës Shengen.

Xhemal Gjunksi – Unë nuk jam kundër, sepse e ka caktuar...

Ermonela Felaj – Problemi nuk qëndron në faktin se ne jemi duke krijuar një agjenci, por po bashkëpunojmë me këtë agjenci.

Xhemal Gjunksi – Atëherë, në emërtim në raport të bashkëpunimit midis shtetit shqiptar dhe Agjencisë Europiane të Rojës Bregdetare dhe të sigurimit të kufijve duhet të jemi shumë të qartë në termat që do të paraqesim që të mos biem në kundërshtim me ligjin dhe me...

Ermonela Felaj – Gjithsesi, kolegët e dinë se në rastet e projekt marrëveshjeve ne nuk mundemi t'i ndryshojmë marrëveshjet që arrihen ndërmjet qeverisë sonë dhe këtij enti european, thjesht mund të bëjmë sqarime të përmbajtjes së marrëveshjes dhe ta pranojmë ose jo, pra jemi të kufizuar dhe nuk mund të bëjmë ndryshime.

Fjalën e ka zoti Noka dhe më pas zoti Murrizi.

Flamur Noka – Një marrëveshje e këtij lloji e Fronteksit me Shqipërinë, nëse ju jeni në dijeni, a ka në vende të tjera të rajonit marrëveshje të tillë, apo jo? E para.

E dyta, a e konsideroni këtë marrëveshje si rrjedhojë e një suksesi të menaxhimit të kufijve nga ana e qeverisë shqiptare apo si rrjedhojë e dështimit të menaxhimit të kufijve?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zonja Voda, fjala për ju.

Rovena Voda – Unë duhet t'ju them se BE-ja, Komisioni European është në negociata me 6 vendet e Ballkanit Perëndimor për finalizimin e kësaj marrëveshjeje. Së shpejti, pas nesh do ta firmosin Maqedonia e Veriut tashmë, shumë afër finalizimit të kësaj marrëveshjeje është edhe Mali i Zi, ndërkohë në proces janë Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina, por për shkak të strukturës që ka si shtet dihet që procedurat janë më të gjata. Në strategjinë e BE-së e shpallur vjet në shkurt të vitit 2018, siç edhe jua përmenda, një nga detyrat për të

hapur negociatat, pra një hap më përpara në integrimin e këtyre vendeve ka qenë finalizimi i kësaj marrëveshjeje.

Po të kthehemi mbrapa në kohë, do të kthehem edhe në kohën tuaj, ju përmenda marrëveshjen teknike të bashkëpunimit të vitit 2009, por fillesat, në fakt, i ka më 20 nëntor të vitit 2008, ku në Shkup të Maqedonisë është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi midis Ministreve të Brendshme të vendeve të Ballkanit Perëndimor: Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Mali i Zi dhe Serbi qëllimi i të cilit ishte krijimi i një sistemi të shkëmbimit të informacionit dhe pjesëmarrja në një sistem rajonal të paralajmërimit të hershëm të këtyre problematikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Sa i takon pyetjes që shtruat ju, besoj se është një vlerë e shtuar dhe këtu mundohem të jem sa më objektive. Në radhë të parë, mendoj se kjo marrëveshje ka ardhur si një shqetësim i vetë vendeve të Europës për shkak të flukseve të mëdha emigratore. Siç e dimë, emigracioni ka qenë një nga shtyllat kryesore të të gjitha vendeve që kanë pasur kryesinë e BE-së, për shkak të flukseve të mëdha emigratore, duke filluar që nga viti 2014, 2015, nga Siria, Afganistani, Palestina, Iraku, Irani e të tjera. Fillimisht, siç edhe ju bëra pak histori, kjo agjenci u krijua për të ruajtur kufijtë e jashtëm të BE-së, por duke parë që fluksi i emigrantëve ishte shumë i madh, duke filluar nga Turqia, Greqia, sepse ne kemi një vend të BE-së me të cilin ndajmë kufij të gjelbër, por prej të cilit kemi edhe hyrje në territorin tonë të emigrantëve të paligjshëm, besoj se në radhë të parë kjo ka ardhur si shqetësim i vetë vendeve të BE-së, pa diskutim që është një vlerë e shtuar në rritjen e sigurisë kufitare.

Pra, duke pasur parasysh eksperiencën e gjatë të bashkëpunimit, pavarësisht statusit vëzhgues që kanë pasur oficerët e Fronteksit në territorin e Republikës së Shqipërisë, patjetër Shqipëria ka një standard, pra Departamenti i Policisë Kufitare dhe Emigracionit derisa ata vijjnë dhe kërkojnë të bashkëpunojnë dhe të bëjnë plane operationale të përbashkëta me Policinë tonë Kufitare dhe të Emigracionit.

Gjithashtu, me aq sa kam dijeni, në Akademinë e Sigurisë është përfshirë edhe një kurrikul 3-mujore, duke u bazuar në kurrikulën e Fronteksit, e cila është një risi, por edhe diçka shumë e mirë për të trajnuar oficerët tanë të Kufirit dhe të Emigracionit në bazë të kurrikulave të Fronteksit dhe standardeve që ofron kjo Agjenci.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Noka, e ka fjalën.

Flamur Noka – Fronteks është një agjenci, e cila përgjithësisht merret me menaxhimin e flukseve të emigracionit ndërkufitar. A mos është Shqipëria vendi i vetëm, ku

në marrëveshje përveçse menaxhimit të emigracionit shtohet edhe menaxhimi dhe lufta kundër trafikeve, kryesisht drogave? A mendoni se ne jemi i vetmi vend ku kjo gjë është futur në mënyrë specifike jashtë kuadrit të punës së Fronteksit dhe ky është një problem i madh për ne?

Ermonela Felaj – Po, zonja Voda.

Rovena Voda – Lufta kundër drogës nuk është e shkruar asgjëkund në këtë marrëveshje. Po jua theksoj edhe një herë, është për të ardhur keq ndonjëherë edhe për mediet, sepse e mbaj mend që në fillim, marrëveshja që ne kemi nënshkruar ka qëndruar shumë besnike, pra në standardet e marrëveshjes që kanë vetë vendet europiane për këtë Agjenci. Siç jua përmenda në fillim, janë tri shtylla fokusi kryesor i kësaj marrëveshjeje: lufta kundër emigracionit të paligjshëm, lufta kundër krimit ndërkufitar, që do të thotë kontrabandimit të emigrantëve, trafikimit të qenieve njerëzore dhe terrorizmit. Patjetër, ndërmjet flukseve të përziera emigratore pse jo mund të ketë elemente, sepse ashtu siç është emigracioni edhe terrorizmi është një nga sfidat apo një nga prioritetet kryesore e vendeve të BE-së.

Para se të vija këtu, printova diçka nga faqja zyrtare e Fronteksit, në mënyrë që t'ju bëja një prezantim, pavarësisht se i rashë shkurt, sepse nuk pata shumë kohë. Në qoftë ju do ta lexoni (sepse unë e kam në anglisht dhe ndoshta nuk mund ta ndaj me ju, megjithatë gjithsecili prej jush mund të hyjë në atë faqe dhe të shohë qëllimin dhe fushën e veprimit e kësaj agjencie), këtu në asnjë vend nuk thuhet droga, por mbetet ajo që ne kemi thënë në relacion. Pra, fusha e veprimit të kësaj agjencie është pikërisht lufta kundër emigracionit të paligjshëm, operacioneve të kthimit dhe riatdhesimit, pra lufta kundër ripranimit të emigrantëve të paligjshëm, si dhe krimit ndërkufitar, në sensin e kontrabandimit të emigrantëve të paligjshëm, ndërmjet të cilëve mund të ketë edhe trafikim të qenieve njerëzore dhe të terrorizmit.

Flamur Noka – Qëllimin e marrëveshjes dhe funksionin e Fronteksit të gjithë ne e dimë shumë mirë, por problemi është nëse është shqetësim, a ka ardhur Fronteksi, vetëm për menaxhimin e kufijve për arsye të migrimit apo edhe për arsye të krimit ndërkufitar, i cili është një shqetësim mjaft i madh dhe të trafikut të drogave? Kjo është pyetja që unë ju kam bërë, a është apo nuk është kjo marrëveshje për këtë arsye? A është shqetësim i vendeve të BE-së çështja që po ju them?

Rovena Voda – Jo, këtë e them me përgjegjësi të plotë. Unë kam qenë kryenegociatorja e kësaj marrëveshjeje dhe absolutisht ky nuk ka qenë shqetësim i vendeve të BE-së për finalizimin e kësaj draft-marrëveshje.

Faleminderit!

Paulin Sterkaj – Unë nuk po e kuptoj pyetjen që po ngrini ju, zoti Flamur. Fronteksi as drogën nuk duhet ta kapë? Ta lëshojë se nuk e ka në juridiksion? Pra, ata do të punojnë dhe do t'i kapin të gjithë ata që shkelin ligjin, por pyetjen tuaj nuk arrij ta kuptoj, sepse ju patjetër doni t'i politizoni gjërat.

(Diskutim pa mikrofon)

E di unë, se e ke me qejf atë punë. Fronteksi po hasi një trafik droge apo çdo lloj krimi, do ta denoncojë dhe do ta dokumentojë, prandaj nuk e kuptoj se ku qëndron problemi dhe arsyeja pse të shqetësohemi. Gjithandej ku luftohet krimi, droga, emigracioni i paligjshëm. Është sukses i çdo vendi anëtar të NATO-s, si dhe i atyre që aderojnë të futen në NATO.

Flamur Noka – Unë nuk jam i shqetësuar Paulin, sepse Shqipëria është bërë Kolumbi, është bërë Meksikë sa i takon krimit...

(Diskutime pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem, kolegë, të qëndrojmë te projekti!

Rrënja e fjalës Fronteks tregon se kjo është një Agjenci e krijuar për kufirin dhe kërkon ta mbrojë kufirin nga ato veprime që u thanë deri tani nga zëvendësministrja, sipas marrëveshjes.

Po, zoti Murrizi, e ka kërkuar fjalën. Më pas e kanë fjalën e ka zoti Salianji dhe zoti Çela.

Myslym Murrizi – Zonja zëvendësministre, ardhja e Fronteksit këtu është kërkesë e qeverisë shqiptare apo është kërkesë e BE-së?

Në fjalën tuaj shpjeguese, kur iu përgjigjët pyetjeve të disa prej kolegëve, ju thatë se ata do të trajnojnë oficerë. Këta vijnë për të ruajtur kufirin apo për të hapur kurse shkolle?

Në relatimin tuaj, kur parashtuat sukseset e ardhjes së Fronteksit, thatë se jemi vendi i parë në Ballkan. Meqë jemi vendi i parë në Ballkan, kjo është arritje, fanar ndriçues?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zonja Voda.

Rovena Voda – E di se keni shumë qejf të kthehemi mbrapa në kohë!

Sa i takon marrëveshjes, jua përmenda që në fillim dhe besoj se isha mjaft e saktë, në strategjinë e BE-së për Ballkanin Perëndimor një nga kërkesat...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, më lini ta mbaroj fjalinë, sepse nuk më detyron dot ta kthej përgjigjen ashtu siç e doni ju!

Ermonela Felaj – Zoti Murrizi ishte konciz në pyetjet e tij...

Rovena Voda – Fjalja gjithmonë fillon me kryefjalë.

Ermonela Felaj -... prandaj zonja Voda, ju lutem, mundohuni të jeni sa më koncize në përgjigjet tuaja!

Rovena Voda – Në strategjinë e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor është cilësuar i domosdoshëm finalizimi i marrëveshjes me Fronteksin si një hap përpara, sigurisht për hapjen e negociatave për në Bashkimin Europian.

E dyta, sa i përket trajnimeve, nuk jua thashë që vijnë për trajnime, por në sensin që, kur oficerët tanë të Policisë Kufitare punojnë me ta, kjo gjë patjetër është një vlerë e shtuar në drejtim të kapaciteteve të burimeve njerëzore, por pse jo edhe logjistike, duke përdorur mjetet e tyre. Unë nuk shoh asnjë gjë të keqe këtu, vetëm *best practices*.

Nëse do të kalojmë te fanari ndriçues, është mirë që Shqipëria të jetë fanar ndriçues dhe mua më vjen shumë mirë për këtë dhe e them me krenari.

Ermonela Felaj – Zoti Murrizi, keni pyetje apo koment?

Myslym Murrizi – Për ta rrumbullakosur pak nga uji i zëvendësministres, kemi qenë për 50 vjet fanar ndriçues, nuk jeni ngopur ende?

Tani po ju marr '97-ën, si aktor i asaj kohe, edhe si ish-deputet. Ndhmën e kërkon i dobëti, por '97-a nuk u trumbetua nga asnjë politikan, as nga qeveria që ishte suksesi i ardhjes së ALBA-s këtu. Shteti çoi poturet te këmbët dhe erdhi ALBA...

(Diskutime pa mikrofon)

Si të vjen keq ty, për '97-ën?

(Diskutime pa mikrofon)

Rovena Voda – Unë ju përmenda vitin 2008, kur keni bërë marrëveshjet e para teknike me Fronteksin, ndërsa ti më kthehesh mua tani...

(Diskutime pa mikrofon)

Po në 2008-ën ju keni qenë dhe shumë mirë që e keni bërë, realisht...

Myslym Murrizi – Për 2008-ën fol me Flamurin.

Zonja Zëvendësministre, sa herë vijnë të huaj këtu, ne nuk i kemi punët në rregull, sepse ata ose vijnë për të na ndihmuar, ose vijnë si pushtues. Kaq.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Fjalën e ka zoti Salianji dhe më pas zoti Çela.

Ju lutem, vetëm pyetje që t'i lini kohë vetes edhe për diskutime!

Ervin Salianji – Pyetjet u bënë, por këtu thuhet se marrëveshja është propozuar nga Bashkimi Europian. Së pari.

Së dyti, ju si pjesë e qeverisë, e shihni se Shqipëria është e para në këtë kërkesë nga ana e Bashkimit Europian, për shkak të menaxhimit të mirë që i keni bërë kufijve deri më sot apo për shkak të keqmenaxhimit të kufijve që ka bërë qeveria e Shqipërisë qoftë në raport me emigracionin apo me kërkesat për azil, duke mos i kontrolluar në mënyrë të hollësishme personat që largohet nga territori, qoftë në raport me tonelatat me drogë që kapen çdo ditë në vendet e Bashkimit Europian, apo qoftë edhe me format e tjera të paligjshmërisë që policia shqiptare jo vetëm që nuk i ka ndaluar, por i ka stimuluar në këtë vend.

Së treti, a është e vërtetë, dhe nëse mund të na e konfirmoni, pasi në pikën 5, ku thuhet “Kontrolli kufitar”, kjo nënkupton që qytetarët shqiptarë do të kontrollohet përveçse nga policia shqiptare edhe nga pjesëtarë të policisë apo të operacionit të Fronteksit? A mund të na e konfirmoni se do të ketë një kontroll të dyfishtë në kufi për shtetasit shqiptarë, të cilët duan të dalin nga territori i Republikës? Kjo është te pika 5.

Çfarë kuptoni ju me kontroll kufitar? Pra, nënkuptoni kontrollin e personave në përgjigje ekskluzivisht të qëllimit të kalimit të atij kufiri, pavarësisht nga ndonjë konsideratë tjetër, i cili përbëhet nga kontrolli kufitar në pikat e kalimit kufitar dhe mbikëqyrja kufitare e pikave të kalimit kufitar?

Ermonela Felaj – Zonja Voda, fjala për ju, meqenëse ju keni marrë pjesë në negocimin e marrëveshjes, ju lutem, na ndriçoni pak më shumë për përmbajtjen e pikave që janë nëshkruar në marrëveshje!

Rovena Voda – Kjo marrëveshje vjen në një moment kur kapacitetet profesionale të Departamentit të Kufirit, të Policisë dhe të Emigracionit janë rritur, kjo për shkak të eksperiencës, të procedurave standarde, të ligjit të ri për kontrollin kufitar në përputhje me *acquis communautaire* të BE-së, për shkak edhe të një eksperience të krijuar që me marrëveshjet e vitit 2008 dhe 2009. Patjetër që janë kapacitetet profesionale të Policisë Kufitare dhe Emigracionit. Mjafton t'ju them se policët tanë të Kufirit dhe Emigracionit kanë qenë aktivë në disa operacione të Fronteksit dhe janë vlerësuar shumë prej tyre, madje ata

kanë qenë pjesë aktive edhe e operacioneve të kryera në bashkëpunim edhe me vendet fqinje. Janë bërë disa operacione në bashkëpunim, ku oficerët tanë kanë qenë të vlerësuar për këtë gjë. Sa i përket kontrollit kufitar, unë e përmenda që në fillim që fokusi i marrëveshjes është sigurisht menaxhimi i flukseve migratore, pra flasim për imigrantë të paligjshëm, për persona që vijnë nga vendet e treta për t'u futur në pikat e kalimit kufitar ose në kufirin e gjelbër të Shqipërisë. Në çdo rast duhet mbajtur në vëmendje që oficerët e Frontex-it gjithmonë do të jenë të shoqëruar bashkë dhe do të veprojnë me një plan operacional pune me oficerët tanë të kufirit dhe migracionit, pra absolutisht nuk flasim për kontrole të dyfishta, por flasim për punë të përbashkët, veprim të përbashkët dhe operacione të përbashkëta.

Ervin Salianji – Nuk u përgjigjet drejtpërdrejt. Pra, nëse unë e kuptova drejt, kontrolli do të bëhet në operacione të përbashkëta nga oficerë ose policë të Frontex-it dhe policisë shqiptare. Pra, ju e shihni këtë si një mirëmenaxhim të kufijve deri sot, prandaj Bashkimi European po sjell kontrole të dyfishta, meqenëse deri sot ka qenë kontroll shumë i mirë.

Së dyti, ju thoni që Shqipëria është po njësoj, nëse e kuptova edhe këtë drejt, për shkak se deri sot kemi shkëlqyer në menaxhimin e kufijve dhe, meqenëse kemi rritur kapacitetet e Policisë së Shtetit, kontrolli po dyfishohet.

Rovena Voda- Më vjen shumë keq, por edhe në progresraportin e Komisionit European asnjëherë Policia e Kufirit dhe Migracionit nuk ka qenë e goditur ose të ketë marrë notë negative.

Ermonela Felaj- Ju lutem, do të mjaftonte të shikonit se kush është bërë pjesë e kësaj marrëveshjeje të ngjashme nga të gjitha vendet europiane, për të kuptuar që nuk ka asnjë çudi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është vetëm Shqipëria, por është një listë e tërë, është një detyrim i përbashkët i të gjitha vendeve që janë në hapësirën shengen. Për më tepër do të doja t'iu tërhiqja vëmendjen kolegëve se kjo nuk është një çështje e re, e lindur sot. Në shkurt të një viti më parë ka ardhur komisioneri european për Migracionin, zoti Avramopoulos, i cili ka pasur një takim me ish- ministrin e Brendshëm. Një nga qëllimet e atij takimi ka qenë nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje mes policisë shqiptare dhe Agjencisë Europiane për Rojën Bregdetare dhe Kufirin, që është një marrëveshje që e vë Shqipërinë në të njëjtën pozitë me vendet e tjera europiane dhe ku kërkohet bashkëpunimi i Shqipërisë. Kuptohet që Shqipëria për çështje të migracionit është përdorur gjithmonë si vend transit. Nuk është se ne kemi pasur probleme

nga emigrantët e paligjshëm, që kërkojnë të vijnë në Shqipëri. Gjithë kufiri i gjelbër, ose kufiri blu, është përdorur për të kaluar në vendet e Europës Veriore ose më tej.

Isuf Çelaj- Përsëritje!

Ka ekzistuar një marrëveshje në nivel teknik mes Frontex-it dhe Republikës së Shqipërisë. Çfarë ka çaluar deri tani që po bëhet një marrëveshje e re?

Së dyti, sa i takon standardit të bashkëpunimit, në marrëveshjen ekzistuese ishte në nivel teknik dhe në parimin e partneritetit, ndërsa marrëveshja e re sjell prezencë të oficerëve të huaj me armë në Republikën e Shqipërisë. Pse kjo?

Rovena Voda- Unë e përmenda që marrëveshjet e para teknike janë nënshkruar që në vitin 2009 me Frontex, por statusi ka qenë ai i vëzhguesve, ndërkohë që marrëveshja është në linjë me të njëjtën lloj marrëveshjeje që ekziston midis vendeve të BE-së ndërmjet tyre, për shembull Italisë dhe Francës, Francës dhe Gjermanisë e të tjera.

Ideja ka qenë sigurisht që oficerët e Frontex-it të mund të marrin fuqi ekzekutive bashkë me oficerët tanë të kufirit dhe emigracionit në kryerjen e operacioneve të përbashkëta të vendosura gjithmonë me një protokoll të përbashkët ose plan operacional të përbashkët pune të miratuar nga të dyja palët. E theksoj edhe një herë se shqetësimi i madh ka ardhur për shkak të flukseve migratore, nisur nga rruga që dihet tashmë Turqi, Greqi. Këto janë rrisitë e kësaj marrëveshjeje, e cila e ngre në një stad më të lartë operacional bashkëpunimin me Frontex-in.

Ermonela Felaj- A ka pyetje të tjera?

Andon Frrokaj-Pyetjet thuajse u ezauruan, por unë dua të shtoj dy fjalë. Së pari, do t'i drejtohesha zëvendësministres ta marrë më me dëshirë pyetjen e bërë nga kolegët dhe t'i kushtohet më shumë përgjigjes ndaj pyetjeve që shtrohen. Shqipëria është e para në këtë marrëveshje, nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, a ka statistika të hyrjes së emigrantëve në Shqipëri dhe a mos vallë për shkak të numrit më të madh të hyrjes në Shqipëri jemi zgjedhur ne të parët në këtë marrëveshje?

Rovena Voda- Unë mendoj se përgjigjet e mia kanë qenë korrekte dhe patjetër me përkushtim ndaj të gjithë deputetëve pa dallimin më të vogël.

Së dyti, sa i përket fluksit të migrantëve, unë ju them që nuk është se Shqipëria është prekur nga një numër më i madh migrantësh, fluksin më të madh, në fakt, e ka pasur Maqedonia, që ka arritur në 1 milion deri në vitin 2016, për shkak të hapjes së kufirit të emigrantëve që vinin nga Turqia, Greqia, Serbia, Hungaria, që është rruga e njohur e emigrantëve të paligjshëm për në vendet e BE-së. Po një numër kaq të madh ka pasur edhe

Serbia, si edhe Bosnje-Hercegovina, madje është ndërhyrë me ndihma emergjente nga vendet e BE-së, sepse emigrantë të paligjshëm kanë qenë të shtrirë në rrugët e Sarajevës. Unë them se të gjitha këto vende janë në përfundim të finalizimit të kësaj marrëveshjeje. Ne bëmë mirë që kemi nxituar, unë e theksoj se është një vlerë e shtuar. Aq më mirë nëse kemi kapacitete të shtuara njerëzore dhe logjistike. Unë e shoh edhe vlerë të shtuar edhe për një fakt tjetër, sa u përket emigrantëve të paligjshëm që hyjnë nga kufiri me Greqinë, shpesh herë ka pasur kthime vullnetare, por shpeshherë marrëveshjet e ripranimit, për shkak se nuk ka një protokoll të veçantë me shtetin tonë fqinj, Greqinë, herë janë zbatuar, herë jo. Unë mendoj se pikërisht qenia në kufirin e gjelbër me shtetin tonë fqinj, me Greqinë, edhe të oficerëve të Frontex do të shërbejë si një provë për ato raste kur ato emigrantë që vërtetohet që kanë ardhur nga kufiri i gjelbër me Greqinë të mund t'i kthejmë në vendin nga kanë ardhur duke respektuar marrëveshjen e ripranimit BE-Shqipëri.

Pra, të nderuar deputetë, unë theksoj se kjo është një vlerë e shtuar në rritjen e sigurisë kufitare dhe menaxhimin e flukseve migratore të paligjshme.

Ermonela Felaj- A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Nokaj.

Flamur Noka-Zonja zëvendësministre, ne të gjithë e kuptojmë se çfarë është kjo marrëveshje dhe si ka ardhur, pse është imponuar, kështu që mos na e paraqisni si sukses të madh të qeverisë. Pse po e them? Në rast se do të ishte çështja e menaxhimit të flukseve të migracionit ndërkufitar, nuk kishte nevojë Frontex-i të vinte në Shqipëri, sepse menaxhonte kufirin e Greqisë me Turqinë, se andej vijnë refugjatët dhe nuk kishte asnjë nevojë që të impononte këtë marrëveshje me Shqipërinë. Ne jemi i pari vend jashtë BE-së që Frontex ka rol operacional dhe ky është alarm. Ne i përshëndesim, sepse ato po vijnë të ruajnë kufijtë tonë, por për ne është alarm, sepse kemi kufij të shpartalluar, kështu që mos na fyeni duke u munduar që dështimin të na e paraqisni si sukses, sepse është fyerje shumë e rëndë.

Ermonela Felaj – Meqenëse këtu kemi dy ish- ministra, pjesa që meriton të lavdërohet është Policia Kufitare, të cilën një pjesë e deputetëve, edhe unë kemi shkuar ta takojmë vetë dhe për të cilën mund të themi se është një aset që meriton të mbështetet dhe të vlerësohet.

Zëvendësministrja, unë dhe ju do të jemi sot e nuk do të jemi nesër, por kjo marrëveshje i mbetet vendit, kështu që, meqenëse fjala është për Shqipërinë, Shqipërisë i vlen kjo marrëveshje.

Flamur Noka- Dakord jam që duhet përshëndetur marrëveshja dhe e përshëndetëm, por mos harro dështimi nuk mund të na shitet si sukses,

Ermonela Felaj- U fol për një marrëveshje për Republikën e Shqipërisë, nuk u fol për një marrëveshje që i vlen qeverisë.

Kalojmë në votimin në parim të marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian të Republikës së Shqipërisë.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Kalojmë në diskutime.

Fjala është për zotin Braimllari.

Endrit Braimllari – Faleminderit!

Nuk doja të bëja pyetje sa i përket kësaj marrëveshjeje, sepse kolegët e opozitës i bënë pyetjet dhe ne e morëm informacionin e duhur për shqetësimin që ka opozita.

Ajo çka më shqetëson në raport me këtë marrëveshje është çka ju thatë sa i përket vendit. Sigurisht, është e rëndësishme të ketë një marrëveshje me partnerët për sigurimin e kufijve, sepse të gjithë ne jemi të vetëdijshëm që kjo marrëveshje nuk po vjen thjesht për monitorimin e kufijve sa i përket kalimit të refugjatëve, por ka një problem më madhor, që ka të bëjë me sigurinë e kufijve shqiptarë, të cilët, këto vitet e fundit kanë një nivel të lartë pasigurie. Sigurisht, kjo për shkak të kësaj politike, të cilën e kemi denoncuar prej kohësh, sepse ka radarë që fiken dhe ndizen me urdhër politik, dhe këtë fakt e ka jo vetëm opozita, por janë edhe përgjimet e antimafias, e keni kthyer vendin në rrugë kalimi të drogave të forta, kokainë dhe heroinë, ta lëmë mënjane punën e kanabisit, sepse tanimë është bërë shqetësuese kur e përmendim kanabis. Nga ana tjetër, ajo që është e rrezikshme ka të bëjë me pikat kufitare, ku pasiguria është lartë dhe kjo është evidentuar nga agjencitë e tjera ligjzbatuese ose edhe nga institucionet ndërkombëtare.

Unë mendoj se sa i përket eksperiencës që duhet të ketë personeli shqiptar me këtë marrëveshje mendoj se trajnimi i personelit ose shkëmbimi i eksperiencave është i rëndësishëm, por ne nuk vuajmë për profesionistë të fushave, as për ekspertë, ne vuajmë për vullnet politik të kësaj qeverie për të luftuar krimin dhe siguruar kufijtë. Kjo marrëveshje është e rëndësishme, por thelbi kryesor i saj është të parandalojë atë që qeveria nuk e thotë dot, trafikun e drogave të forta, por edhe të sigurisë së kufijve shqiptarë, sepse të vish në një vend dhe të marrësh të parën masë në raport me trupën operationale, do të thotë që këto trupa

do të veprojnë të armatosur në kufijtë shqiptarë. Ky është shqetësimi që ne kemi ngritur prej kohësh dhe kjo vërtetohet edhe nga partnerët ndërkombëtarë. Votën e kemi pro për këto marrëveshje që i shërbejnë vendit, por duhet të jemi transparentë përballë shqiptarëve se për çfarë bëhen këto marrëveshje.

Luan Rama- Faleminderit!

Unë falënderoj zëvendësministren dhe përfaqësuesit për sqarimet që dhanë.

Së dyti, dua të theksoj se kjo marrëveshje është një stad tjetër bashkëpunimi midis strukturave të Bashkimit Europian dhe strukturave tona të sigurisë në rastin konkret të të gjitha atyre forcave që ligji detyron të jenë pjesë e menaxhimit të integruar të kufijve të Republikës së Shqipërisë.

Natyrisht, duke evidentuar ndonjë defekt ose mangësi, ne nuk njollosim aspak as punën e strukturave të Ministrisë së Brendshme, as ato të kufirit, pasi gjithçka është arritur dhe fakti që Shqipëria jo vetëm është vend anëtar i NATO-s, por gëzon edhe privilegjin e të qenit brenda hapësirës shengen me të drejtën e lëvizjes së lirë, do të thotë që strukturat e kontrollit, menaxhimit dhe ruajtjes së kufirit janë standarde që e bëjnë të vlefshëm këtë realitet.

Ajo që dua të them ka të bëjë me faktin që strukturat tona të Policisë Kufitare kanë ende shumë mangësi sa i përket infrastrukturës, mjeteve të shërbimit. Unë shpresoj që përmes një njohje më të mirë të realitetit nga forcat e Frontex-it, të mund të na ndihmojë për të krijuar një bazë më të mirë mbështetëse. Ata do të vijnë me pajisje dhe do të ketë më shumë fleksibilitet në këtë pikëpamje. Ajo që duhet bërë është kjo, se, nëse flasim për luftë kundër krimit ndërkufitar, për rritje të standardeve të sigurisë, ne jemi një vend që tentojmë të çelim negociatat me Bashkimin Europian dhe aspirojmë të bëhemi pjesë e Bashkimit Europian, por, nëse nuk integrojmë edhe veprimin e strukturave tona me strukturat e BE-së, do të jetë gjithmonë më e largët dhe e vështirë mbërritja në anëtarësimin në BE.

Unë mendoj se duhet të kuptojmë edhe një gjë, fakti që BE-ja kërkon marrëveshje të tilla, do të thotë që diçka nuk funksionon siç duhet në standardet tona të sigurisë në menaxhimin dhe kontrollin e kufijve, sepse, nëse do të ishin këto standarde në atë nivel që do të donim ne dhe në atë nivel që do të donte vetë struktura që e realizon shërbimin, natyrisht nuk do të lindte nevoja për operacione të përbashkëta, ose për ndërveprueshmëri të kësaj natyre.

Duke qenë pro marrëveshjes, natyrisht unë jam pro krijimit të kësaj strukture. Meqenëse këtu janë të ftuar përfaqësuesit e ministrisë, dua të them se është shumë e

rëndësishme që kjo marrëveshje të shoqërohet edhe me akte nënligjore dhe afatet që parashikon procedura të mos krijojnë vakume, të cilat do ta bënin pastaj të pamundur realizimin e të gjithë gamës së veprimtarisë që parashikon marrëveshja, të normojmë mirë të gjithë hapat, autoritetin, të drejtën, detyrimet që kanë trupat përbërëse në operacion.

Nga ana tjetër, do të duhet të shikohet me shumë prioritet çështja e rritjes së standardit të cilësisë së personelit dhe të pajisjeve të forcave të Policisë Kufitare. Është impakti i parë jo vetëm në kuptimin viziv, por edhe të standardit të shërbimit. Ne të gjithë hyjmë e dalim dhe, nëse në Rinas vërejmë një standard shërbimi qytetar apo në një pikë tjetër, këtë nuk e vërejmë në të gjitha pikat e kalimit kufitar. Në këtë pikëpamje, që të jemi të barasvlershëm edhe në marrëveshjen me strukturat e Frontex-it duhet të rrisim cilësinë e shërbimit nga ana e punonjësve tanë, por unë insistoј edhe një herë tek infrastruktura, te pajisja me mjete e të tjera si këto.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Rama, mbi të gjitha, për faktin që sollët në vëmendjen tonë nevojat që ka Policia e Kufirit dhe Migracionit!

Edhe ne e kemi konstatuar në vend një gjë të tillë, madje për herë të parë, në fund të vitit, në këtë komision thirrëm edhe Policinë Kufitare dhe Migracionit së bashku me Ministrinë e Brendshme gjatë diskutimit të buxhetit, me qëllim që të bënim ballafaqimin e nevojave. Premtimi nga Ministria e Brendshme ka qenë se do të ketë një orientim më të mirë të fondeve në drejtim të pikave të kalimit kufitar.

Diçka tjetër që ne kemi bërë gjithmonë nga pozita jonë si parlamentarë është fakti që i kemi kërkuar vazhdimisht Konferencës së Kryetarëve sa herë që janë paraqitur marrëveshje të bashkëpunimit ndërkuftar, që ato të shqyrtoheshin edhe në këtë komision, gjë e cila nuk ka qenë praktikë më herët. Ne kemi përfituar nga rasti që të kërkojmë që pjesë e projekteve që financohen nga fondi IPA, jemi në prag të fazës së tretë të këtij financimi, të bëhen edhe ato momente që lidhe me lehtësimin e dhënies së shërbimit në pikat e kalimit kufitar, që, siç e thatë edhe ju, jo kudo vërehet i njëjti shërbim. Pra, në qoftë se në Rinas shërbimi është i standardeve, shërbimi në Portin e Durrësit po ashtu, ka pika të tjera të kalimit kufitar që ka vonesa, jo për faktin se forcat nuk janë të mobilizuara. Kam parë që punohet në të gjitha sportelet e mundshme, por ndërkohë mungojnë mjetet. Fare mirë çështja e financimit të mjeteve mund të adresohet edhe në këto marrëveshje që financon vet Bashkimi European.

Pra, dua të them që ne e kemi pasur në vëmendje të vazhduar dhe natyrisht që edhe konstatimi nga ana juaj do të na ndihmojë që në të ardhmen të shohim edhe të tjera nevoja që ka kjo strukturë e rëndësishme e Policisë së Shtetit.

Fjalën do t'ia kaloj zotit Qefalia për diskutim dhe pastaj zotit Salianji.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, unë nuk do t'i shtoja asgjë fjalës së fundit të kolegut Rama, pasi ai përfshiu në një optikë të gjerë gjithë problematikën e situatës që kemi, sidomos në kufirin qoftë bregdetar, por qoftë edhe atë tokësor, por do të doja të ndalesha në dy momente: së pari, mendoj se dita e sotme nuk është për të bërë politikë, sepse tema nuk është e tillë. Dëgjova kolegë të mi të opozitës që shtrojnë pyetje të tilla si: “Pse Shqipëria?”, ndërkohë që ne e përmendëm që në krye të herës që janë edhe 6 vende të tjera, të cilat presin ta nënshkruajnë këtë marrëveshje. Nuk bën sens “pse e nënshkroi e para”! Çfarë rëndësie ka kjo? Duhet ta nënshkruanim pas vendeve të tjera? I rëndësishëm është thelbi i nënshkrimit dhe vlera që merr nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje për rritjen e masave të sigurisë. Po të ishte se kjo qeveri është e kapur nga krimi, nga droga, përse do ta nënshkruanim këtë marrëveshje? Ne do të na interesonte që të mos kishim mbikëqyrës, të mos kishim marrëveshje të tillë e të vazhdonim të punonim për këtë, por interesi i kësaj maxhorance dhe kësaj qeverie është të konsolidojë kufijtë e saj, të marrë masa për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, por edhe të kapaciteteve teknike që Shqipëria të aspirojë për t'u pranuar në Bashkimin European. Kjo është arsyeja e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, mendoj unë, por fakti që pse e nënshkruam të parët, apo nuk e nënshkruam të dytët, pse u zgjodh Shqipëria dhe jo Serbia, apo Mali i Zi a Maqedonia, këto janë çështje që nuk bëjnë sens. Edhe për ata që ju dëgjojnë nuk japin indikacion pozitiv që ju të jeni të gatshëm për protestën që keni në datën 25, a nuk e di se kur.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ju lutem, çështja e organizimit të protestave nuk është pjesë e diskutimit në këtë komision!

Fjala për zotin Salianji.

Ervin Salianji – E ka më shumë shqetësim Xhemali se ne!

Ermonela Felaj – Xhemalit i keni munguar, ndaj i tha të gjitha këto!

Ervin Salianji – Nuk mund ta trajtojmë këtë sikur nuk është problematikë dhe të mendojmë se jemi të parët ngaqë jemi më të mirët, por është e kundërta, marrëveshja e propozuar nga Bashkimi European certifikon të gjitha ato që ne kemi thënë prej kohësh. Nuk

është aspak e vërtetë që ka të bëjë vetëm me emigrantët apo me kalimin e paligjshëm të kufirit të emigrantëve dhe me menaxhimin e tyre, sepse, nëse do të ishte kështu, do të kishte emergjencë në Maqedoni dhe në Serbi, ku rrugët e kalimit të emigrantëve janë shumë më të shpeshta e me fluks më të madh se Shqipëria.

Këtu kemi një situatë emergjente, dhe gazeta prestigjioze britanike “The Independent” thoshte se Shqipëria është kthyer në Kolumbinë e Europës, gjenerohen miliarda euro nga krimi dhe të gjitha këto kalojnë nëpërmjet kufijve. Departamenti Amerikan i Shtetit në një raport ka thënë se Shqipëria është kthyer në qendër operationale për trafikun e kokainës dhe drogave të rënda. Pra, jemi në një situatë ku Bashkimi European po kërkon që të vendosë kontroll në Shqipëri që vet shteti sot, qeveria shqiptare dhe Ministria e Brendshme nuk e ka. Ne nuk po godasim dhe as po merremi me çështjet e Policisë së Shtetit apo me policët që shërbejnë dhe aftësitë e tyre profesionale, por me një pjesë të policisë dhe me drejtimin politik të saj, të cilët e kanë kthyer një pjesë të saj në shërbim të krimit dhe të bandave.

Pse është certifikim? Sepse edhe sot e kësaj dite që flasim, kemi drejtues policie, drejtor policie në Vlorë dhe shefa policie që janë në kërkim për shkak të bashkëpunimit me krimin. Për këtë arsye, pa diskutim, për ne si opozitë, që e kemi kërkuar prej kohësh, por edhe për të gjithë shqiptarët është një lajm i mirë që Bashkimi European sjell në Shqipëri në mënyrë emergjente një njësi të specializuar për të bërë kontrollin e shumëfishtë të kufirit, ndaj e votuam dhe do ta votojmë. Pa diskutim që do të ishte një lajm i keq nëse nuk do të zbatohet me rigorozitet, siç ka hapësira në marrëveshje për kontroll apo për drejtimin nga policia shqiptare që të kthehet në fatkeqësi që Bashkimi European të marrë masa të tjera deri në rikthimin e vizave për qytetarët shqiptarë për shkak të keqmenaxhimit të kufirit nga ana e policisë dhe qeverisë shqiptare.

Jeni të pabesueshëm, dhe pa diskutim që është e pabesueshme që edhe në këtë situatë ku gjendja është në nivele alarmante, të dalim e të themi, apo të përpiqemi të tallemi me qytetarët shqiptarë duke thënë se kjo marrëveshje është sukses i qeverisë. Duhet t'i shohim siç janë situatat që të kemi mundësi të përmirësohemi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjala për zotin Vorpsi.

Sadri Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

I vlerësoj maksimalisht pyetjet që bënë kolegët opozitarë lidhur me marrëveshjen! Sigurisht që begraundi i tyre institucional mbart vlera në këtë diskutim, sikurse edhe e mirëkuptoj retorikën politike që po shfaqin sot në këtë takim të parë, pas vitit të ri. Natyrisht, është opozitë, sikurse ne në kahun tjetër, vite më parë, të njëjtën gjë do të kishim bërë, por të mos harrojmë se kemi të bëjmë me një marrëveshje tip, që ashtu sikurse edhe ata vetë thonë se janë gati ta votojnë, rrit sigurinë kombëtare, sikurse edhe njëkohësisht rrit shkallën e bashkëpunimit karshi partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Ndaj mendoj që opozita retorikën politike duhet ta shfrytëzojë në ato 20 minuta në seancë plenare dhe jam i bindur që kanë ç'të thonë aty gjatë atij minutazhi, madje dalin edhe nga rendi i ditës, kështu që kam mendimin ta miratojmë dhe të presim seancën plenare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vorpsi!

E shprehëm në parim dakordësinë dhe besoj që vetëm prova e “Shën Thomait” ka ngelur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...se sa vlerë të shtuar pati kjo që jemi duke diskutuar sot. Kështu që për të qenë më racionalë, do t'i ftoja kolegët që ndërkohë ta votonin këtë marrëveshje...

(Mungesë incizimi)

Myslym Murrizi – Absolutisht, jemi dakord!

Siç e tha edhe kolegu i maxhorancës, me thënë të drejtën, nuk kam qejf të jem fotokopje e një fryme konfliktualiteti mes pozitë-opozitës në traditën 28-vjeçare. E vërteta është që ardhja e çdo prezence të huaj ndërkombëtare në këtë vend, në këta 28 vjet post-komunizëm, nuk ka treguar që qeveria ka qenë në binarë, që shteti ka qenë i fortë dhe kanë ardhur të huajt, ndaj mora shembullin e vitit '97, me zonjën zëvendësministre, as për nostalgji dhe as për mburrje për qeverinë e asaj kohe. Ata vijnë këtu se e dinë se janë ende 4 komisarë policie, Jajar Çela, Gjergj Koilo, Sokol Bode që e emëruat ju me tam-tam-e të mëdha për të ruajtur kufirin, nuk është kapur ende. Ka dy vjet që vjen vërdallë, do të shkojë ta marrë Ardi Veliaj me makinë në ndonjë ngrehinë kur të bëjë vetëdorëzimin me ceremoni.

Ali Gripshi, deputet i Peqinit në atë kohë, tha: “Mirë që vijnë këta të ALBA-s që na ruajnë, po këta vet kush do t'i ruajë?”. Ishalla vijnë e bëjnë punë të hairit, Ermonela! Ishalla nuk mësojnë shqip shpejt dhe të familjarizohen me këta të katërt që kanë ikur, se ka edhe të tjerë si këta. Nëpër kafene dëgjojmë barsoleta që të huajt zihen për të ardhur të punojnë në Shqipëri, sikurse zihen shqiptarët për të hyrë në doganë.

Kjo është në kuadër të programit makro të qeverisë suaj, mos e quani sukses! Është një farë dhënie me koncesion, siç po jepni me PPP, tani keni dhënë edhe ruajtjen e kufirit me PPP. Dhatë me PPP qeverisjen, ia dhatë shoqërisë civile, ndaj edhe thashë a do të kem karrige këtu apo jo, se janë hequr 16 ministra, të cilët do të vijnë nëpër komisione, kanë shkuar 16 nga gjimnazi në qeveri. Shumë mirë bëjnë që vijnë, madje pas tyre propozoj të vijë edhe policia, pjesë nga Ministria e Brendshme, gjithë të BE-së. Të heqim ata 12 mijë policë që kemi e të vijnë t'i zëvendësojnë ata, pastaj të vijnë doganat. Nga Ministria e Arsimit nuk ka problem, se nga matanë tokës sonë i kemi marrë, po e japin shembullin ministrat. Sa më shumë të vijnë, më mirë është!

Ju faleminderit!

Flamur Noka – Të gjitha vendet jashtë Bashkimit Europian, marrëveshjen me Frontex-in e kanë thjesht për trajnime, shkëmbim informacioni dhe për analizë risku. Jo rastësisht jemi vendi i parë jashtë BE-së që nënshkruajmë një marrëveshje të imponuar nga BE-ja, ku Frontexi-t i jepet rol operacional, pra rol ekzekutiv. Kjo që na u paraqit si sukses, në fakt është dështim i paralajmëruar. Ne si opozitë e përshëndesim Bashkimin Europian si iniciatorin e kësaj marrëveshjeje, përshëndesim dhe marrëveshjen gjithashtu të propozuar nga BE-ja, por kjo marrëveshje tregon qartë atë që ne e kemi thënë vazhdimisht, e kanë thënë ndërkombëtarët, po e thonë edhe mediat prestigjioze ndërkombëtare: “Shqipëria është kthyer në një han pa porta, ku hyjnë dhe dalin derri dhe dosa! Askush nga forcat përgjegjëse të shtetit shqiptar nuk mund të menaxhojë kufijtë territorialë, qofshin ata jeshilë apo ata detarë!”.

Pse BE-ja imponoi një marrëveshje të tillë? Ja cili është shkaku: një gazetë prestigjioze britanike “The Independent” thotë qartë se kjo marrëveshje erdhi si pasojë e shqetësimit të BE-së, sepse Shqipëria është Kolumbia e Europës, është prodhuesi dhe shpërndarësi më i madh i drogës së lehtë, që është marijuana, dhe një ndër shpërndarësit kryesor

të drogave të forta. Nuk ishin rastësi fabrikat e prodhimit të kokainës në Shqipëri. Ndër të tjera kjo gazetë thotë se Shqipëria është narko-shtet. Pra, nuk e thotë vetëm opozita. Pse ndodhemi në këtë moment? Një moment i paralajmëruar me kohë, Shqipëria ka rrëshqitur nën pushtetin e krimit dhe të trafikut. Kjo tashmë është e gjithëpranuar nga gjithkush, përveçse jo nga ju. “Gjithkush” e kam fjalën për faktorët ndërkombëtarë dhe agjencitë ligjzbatuese partnere.

Sipas statistikave, janë miliarda euro drogë që qarkullojnë nëpër kufijtë tanë drejt vendeve të BE-së dhe nga këtu po helmohet rinia europiane. Ky është një shqetësim i madh i tyre, ndaj kjo është një nga arsyet që ata kanë imponuar këtë marrëveshje. Nga këtu po eksportohet dhe po dirigjohet edhe krimi, ndaj ata e kanë kërkuar këtë.

Nuk ishte rastësi, ishte Departamenti Amerikan i Shtetit që para dy vjetësh vuri alarmin që Shqipëria është vend me kufi të pasigurt.

U shkatërruan, si gjithçka tjetër, u shkatërrua policia, u shkatërruan edhe kufijtë. Si pasojë e kufijve të sigurt, ky vend, që quhet Shqipëri, mori liberalizimin e vizave, që të mos e harrojmë. Një nga kushtet për liberalizimin e vizave kanë qenë edhe kufijtë e sigurt. Kufiri ynë tokësor në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit dhe të Komisionit European dikur është konsideruar si kufiri më sigurt i të gjithë Ballkanit ndaj u plotësua edhe kushti për liberalizimin e vizave. Sot është kufiri më i pasigurt i Ballkanit, ndaj po vjen edhe Frontekst me këtë mision, ndaj edhe BE-ja ka imponuar këtë marrëveshje.

Si në çdo aspekt tjetër, Shqipëria është e shpartalluar dhe po shkon buzë greminës. Prandaj mos e paraqisni si sukses faktin që detyrat e policisë shqiptare po i merr përsipër për t'i kryer një mision european si Fronteksti. Shqipëria, në këtë rast Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit, ka marrë një goditje shumë të fortë në çdo aspekt tjetër, si në çdo fushë tjetër. Kjo qeveri po e kthen Shqipërinë në gropë, po e shkatërron. Kjo është edhe arsyeja pse data 16 është një alarm i madh, një makth për ju dhe po vjen dita që shqiptarët të lajnë duart me ju, sepse ju i mbytët në krim, i mbytët në korrupsion, vodhët gjithçka, e shkatërruat këtë vend. Ju e bëtë Shqipërinë një han me dy porta, ku vetëm normalitet nuk ka, ndaj përgatituni për datën 16.

Ermonela Felaj – Kalojmë në miratimin nën për nën të marrëveshjes.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të marrëveshjes? Dakord!

Miratohet marrëveshja dhe, natyrisht, do të hyjë në fuqi në afatin e përcaktuar.

I falënderoj pjesëmarrësit për prezencën e tyre në këtë mbledhje, si dhe për shpjegimet që dhanë. Sigurisht, Agjencia nuk bashkëpunoi me Shqipërinë jo për shkak të problemit të Shqipërisë, por për shkak të problemit që ka Europa në menaxhimin e flukseve migratore. Kjo është e qartë.

U bëj me dije kolegëve se nesër në orën 10:00 do të zhvillojmë një mbledhje me përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme për projektligjin “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar dhe në orën 11:00 do të zhvillojmë një vizitë informuese në ambientet e Forcave Rëna, ku janë të ftuar të marrin pjesë të gjithë kolegët.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA